



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary


DATË/A:	02.05.2024
REFERENC-Ë:	23/5494/MMPHI-DMMU
PËR/ZA/TO:	"LINA-KS", Sh.p.k., Harilaq, Fushë Kosovë Impianti për prodhimin e materilave izoluese & dekoruese kombinuar me stiropor dhe pllaka klinker.
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "LINA-KS", Sh.p.k., Harilaq, Fushë Kosovë, me veprimtarinë: Impiant për prodhimin e materialeve izoluese & dekorues kombinuar me stiropor dhe pllaka klinker, me Nr.Port.23/5494/MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

- Vendimi për Refuzimin e kërkesës për tu pajisur me Leje Mjedisore, për operatorin "LINA-KS", Sh.p.k., Harilaq, Fushë Kosovë, Impiant për prodhimin e materialeve izoluese & dekorues kombinuar me stiropor dhe pllaka klinker

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 23/5494/MMPHI
Datë: 02.05.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 dhe nenit 9 paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M


1. Operatorit, "LINA-KS", Sh.p.k., Harilaq, Fushë Kosovë, me Nr.Prot. 23/5494/MMPHI, i **Refuzohet** kërkesa për tu pajisur me Leje Mjedisore për veprimtarinë: Impiant për prodhimin e materialeve izoluese & dekorues kombinuar me stiropor dhe pllaka klinker.

A r s y e t i m

Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;

Faqe 2 nga 3



- Certifikatën e regjistrimit të biznesit- ARBK;
- Pëlqim Mjedisor me Nr.22/7106/1-ZSP/94/23 të lëshuar me dt. 08.02.2023;
- Njoftimin nga drejtoria për Planifikim Urban e Komunës së F. Kosovës , me nr.549 të datës 06.12.2022;
- Aktvendim nga komuna e F. Kosovës me nr.24, të dt. 29.05.2023;

Operatori nuk ka plotësuar kushtet si më poshtë :

- Nuk posedon lejen ujore për shfrytëzim nga pusi dhe
- Lejen ujore për shkarkim.

Komisioni për Leje Mjedisore pas disa takimeve për shqyrtimin e aplikacionit, ka gjetur që operatori shfrytëzon ujin e pusit, pa posedimin e lejes ujore.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori nuk i plotëson kushtet administrative dhe mjedisore dhe merr Vendim për **Refuzim të kërkesës për tu pajisur me Leje Mjedisore**, në përputhje me nenin 12 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Fushë Kosovë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së